



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:270416

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523637

KF.nr.262/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahiri në kontestin tregtar administrativ të paditësit NTSH “ATEKS”, me seli në Gjilan, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me seli në Prishtinë, Soliteri Avalla P+12, kundër të paditurit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas padisë së paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti rivlerësim malli, vlera e kontestit e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat H.H., nga Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, dhe të përfaqësueses së autorizuar të palës së paditur A.H.D., me datë 14.03.2024 mori, këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH “ATEKS”, me seli në Gjilan.
- II. ANULOHET aktvendimi me nr.07.3/200-2014 i datës 18.10.2021 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë, dhe lënda kthehet në RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE, tek e paditura.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datën 02.12.2021 ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, kundër Aktvendimit nr.07.3/200-2014 të datës 18.10.2021, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe Akcizave, shkeljes esenciale të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative

dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka deklaruar se: Mbesim në tërësi sipas thënieve nga seancat paraprake, duke theksuar se ka pranuar parashtresën e të paditurës, duke konsideruar se e njëjta nuk ka paraqitur gjendjen reale, pasi që nga provat që i kemi dorëzuar me parashtresën e datës 28.02.2024 dhe atë akuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, shihet se objekt shqyrtimi kanë qenë gjithsej 156 deklarata doganore dhe në provat me të cilat prokurori ka propozuar të shqyrtohen në procedurë penale ka qenë pikërisht vendimi i Sektorit të Auditimit, gjegjësisht Raporti i Kontrollit i datës 05.12.2013, që ka të bëjë me deklaratën doganore objekt i padisë. Po ashtu, edhe nga kallëzimi penal i Sektorit të Hetuesisë pranë të paditurës lidhur me këtë çështje ndaj tani paditësit është konstatuar se objekt i shqyrtimit janë 156 deklarata doganore, duke u bazuar në raportin e auditimit të datës 05.12.2013, dhe vendimin e Sektorit të Auditimit të të paditurës. I ka propozuar gjykatës që të aprovon padinë si të bazuar, ta anulojë vendimin kontestues nr.07.3/200/2014 të datës 18.10.2021 me të cilin është vërtetuar vendimi bazë 04.3.3/791 i datës 03.12.2013. Tutje ka theksuar se nuk ka kërkesë për kthim të mjeteve ose lirim nga detyrimet ngase kjo çështje është e gjykuar me aktgjykimin penal të formës së prerë ku objekt trajtimi sipas kallëzimit penal të vetë doganës ka pasur 156 deklarata doganore, dhe gjetjet siç janë marr në aktvendimin bazë 791/03.12.2013. Pra kallëzimi penal i vetë doganës në fq. 5 tek kalkulimi i referohet aktvendimit të doganës 791/03.12.2013 i cili si i tillë është i përfshirë edhe në aktakuzë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 19.04.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka deklaruar se: Mbesim në tërësi pranë deklarimeve të cekura në seancat e datës 23.02.2024, ku në mënyrë të detajuar kemi cekur të gjitha arsyet lidhur me vendimmarrjen dhe mbesim pranë deklarimeve të datës 28.02.2024, sipas parashtresës së dërguar gjykatës, pasi që ndaj paditësit është zhvilluar një procedurë penale, mirëpo e paditura nuk ka mundur të vërtetojë bazuar në shkresat e lëndës, gjithnjë duke pasur parasysh faktin se paditësi në procedurë penale ka bërë pranimin e fajësisë dhe se DUD-at kontestues a janë të përfshirë në çështjen penale, pasi që siç e kemi cekur edhe në parashtresë paditësi në procedurë penale e ka pranuar fajësinë dhe në këtë rast nuk janë administruar provat me aktgjykim penal. E kundërshtoj pretendimin e

fundit, pasi që bazuar në fq.5 të kallëzimit penal evazioni fiskal përveç kësaj është ndarë edhe për dy periudha 2008-2010, pjesë kjo që nuk është përfshirë në aktvendim administrativ, andaj, në situatën konkrete nuk mund të bazohemi vetëm në kallëzimin penal, pasi që e paditura ka autorizime ligjore që komform nenit 82 të bëjë vlerësimin të mallrave në momentin kur siguron prova të reja të cilat nuk ka qenë në momentin e importit. Andaj i propozojë gjykatës që mos të marrë për bazë aktgjykimin penal, pasi që aty kemi pranim të fajësisë për disa deklarata dhe e paditura sie cek më lartë komfor autorizimeve ligjore ka vepruar drejtë kur ka bërë ri vlerësimin e mallit dhe kur ka obliguar paditësin me detyrime doganore shtesë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzojë padinë si të pa bazuar dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat dhe atë: aktvendimi 200/2014 i datës 18.10.2021, urdhëresa e gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik P.nr.412/2014 e datës 21.06.2016, aktgjykimi P.nr.412/14 i datës 21.06.2016 me vulë të plotfuqishmërisë, aktvendimi 200/2014 i datës 11.05.2017, aktgjykimi A.nr.733/14 i datës 19.04.2015, aktgjykimi AA. nr.118/2015 i datës 04.11.2015, aktgjykimi A.nr.2032/15 i datës 21.09.2016, përgjigja në padi e datës 19.04.2022, aktgjykimi PA1.nr.1003/2016, ekspertiza financiare e datës 13.08.2015, e punuar në lëndën P.nr.412/14, aktvendimi 791/03.12.2013, aktvendimi 200/15.04.2014, raporti i kontrolli nr.801/05.12.2013, parashtresat e Doganës së datës 04.07.2013, 13.02.2014, 18.11.2013, 29.01.2013, raporti nga NJIF-K i datës 13.12.2012, korrespondenca e datës 04.10.2021, DUD-at kontestues së bashku me faturat dhe dokumentet përcjellëse, parashtresa e doganës e datës 11.07.2019, verifikimi i deklaratave dhe faturave eksportuese së bashku me deklarata dhe faturat përcjellëse, parashtresa e doganës e datës 28.02.2024, parashtresa e palës paditëse e datës 28.02.2024, aktakuza nr. PP/II.nr.770-2-14 e datës 15.12.2014, kallëzimi penal nr. P-09-2013 i datës 24.03.2013, dhe kërkesa për verifikim e datës 29.01.2013.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, deklarimeve në padi dhe përgjigje në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se Sektori i Kontrollit pas Importues me aktvendimin nr.04.3.3/791 të datës 03.12.2013 i ka ndryshuar të dhënat në Deklaratat Unike Doganore me regjim IM4 për vitet 2010, 2011, 2012 të proceduara në Zyrën Doganore Hani i Elezit në rubrikat 44 dhe 47, duke e obliguar subjektin në procedurë, këtu paditësin që të paguaj detyrime doganore shtesë dhe atë në emër të taksës doganore dhe TVSH-së. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se kundër aktvendimit të lartcekur paditësi ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilin ankesë Dogana e Kosovës me datën 18.10.2021 ka sjell Aktvendimin nr.07.3/200/2014, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit aktvendim paditësi me padinë e datës 02.12.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i aktvendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës - Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve e ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e aktvendimit nr.07.3/200/2014 të datës 18.10.2021, me arsyetim se Dogana e Kosovës në rivendosje pas analizimit të dokumentacionit të verifikuar nga ana e autoriteteve të Turqisë, ka konstatuar se jashtë çdo dyshimi në rastin konkret kemi nënvlerësim të faturave të mallit nga ana e subjektit ankimor, gjithnjë duke pasur parasysh se edhe vet subjekti ankimor në procedurën penale e ka pranuar fajësinë për nënvlerësim të deklaratave doganore. Tutje ka theksuar se Sektori i Kontrollës pas Importuese me të drejtë ka obliguar subjektin ankimor si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, pasi që veprimi i Sektorit të Kontrollës pas Importuese për Deklaratat e lartcekura është në harmoni me dispozitën e nenit 82 par.2 të KDA-së, ku thuhet se *“Dogana, pasi ta ketë lejuar lirin e mallrave dhe më qëllim që të sigurohet për të dhënat e vërteta të deklaruara, në deklaratën doganore, mund të kontrollojë dokumentet tregtare dhe të dhënat që kanë të bëjnë me importin apo eksportin, si dhe veprimet pasuese (të mëvonshme) tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra”*.

Po ashtu e paditura në arsyetim të aktvendimit kontestues ka theksuar se Sektori i Kontrollës pas Importuese ka vepruar në mënyrë të drejtë kur për Deklaratat Unike Doganore konform provave të reja dhe me qëllim të rregullimit të drejtë të situatës ka obliguar subjektin ankimor që të paguaj obligime shtesë, pasi që ky veprim është në harmoni me nenin 82 par.3 të KDA-së, ku thuhet se

“Pa rënë ndesh me nenin 219.3 kur nga rishqyrtimi i deklaratës ose kontrollit pas zhdoganimit gjen se dispozitat që rregullojnë procedurën doganore përkatëse janë zbatuar në bazën e të dhënave jo të sakta apo jo të plota, Dogana, në përputhje me dispozitat në fuqi, do të ndërmerren masat e duhura për të rregulluar situatën e krijuar, duke i marrë parasysh edhe informatat e reja që janë në dispozicion”.

Dhe në fund ka theksuar se dokumentet e prezantuara nga subjekti në procedurë kanë rezultuar të jenë të pasakta, pasi që në procedurën e verifikimit të dokumentacionit përkatës në shëtitin eksportues ka rezultuar se vlera e prezantuar në ato dokumente është e pasaktë (verifikimet në vitin 2013). Mandej pas verifikimit që është bërë në rivendosje (me kërkesë të reduktuar për shkak të mungesës së resurseve humane të Turqisë) ka rezultuar se disa deklaratatë të deklaruara nga subjekti ankimor kanë qenë fiktive pasi që kanë rezultuar në emër të importuesve dhe eksportuesve të tjerë, andaj verifikimi nga autoritetet doganore Turke janë prova të mjaftueshme për të dëshmuar se vlera e deklaruar nga subjekti nuk është vlerë reale e transaksionit, dhe se obligimi për pagesë të taksave shtesë nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese është në harmoni me të gjeturat dhe dispozitat ligjore në fuqi, përmes deklaratave eksportuese të verifikuara që paraqesin mostër të 156 deklaratave dhe faturave ku secila përfshinë periudhën e përcaktuar konform dispozitave të nenit 34 par.2 pika a) të KDA-së dhe nenit 69 lidhur me nenin 71 par.2 të UA 11/2009 për Implementimin e KDA-së mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave.

Në procedurën e kontestit tregtar administrativ gjyqësor, Gjykata pasi ka shqyrtuar gjithë dokumentacionin e lëndës konstaton se nga konkluzionet e nxjerra në procedurën administrative, arsyetimi i vendimit i mangët dhe kontradiktor me dispozitivin, si dhe me provat e theksuara në arsyetimet e vendimeve të paditurës, nuk mund të vërtetohet plotësisht gjendja faktike dhe se ekzistojnë kontradikta në mes konstatimeve të cekura pa i arsyetuar mjaftueshëm me prova konkrete.

Gjykata konstaton se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye mbi faktet vendimtare, të vlefshme për zgjidhjen e drejtë të çështjes në shqyrtim. Gjykata në rastin konkret nuk mund të pajtohet me vërtetimin e gjendjes faktike të paditurit dhe qëndrimin juridik të dhënë në arsyetimin aktvendimit kontestues, kjo për faktin se i padituri në rastin konkret është dashur që të ketë pasur parasysh faktin se kjo çështje është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë në procedurë penale, respektivisht me aktgjykimin P.nr.412/14 të datës 21.06.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 04.10.2016. Po ashtu, i padituri është dashur ta ketë pasur parasysh edhe kallëzimin penal

të Sektorit të Hetuesisë me numër të lëndës H-09-2013 të datës 24.03.2014 dhe aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.720-2/14 të datës 15.12.2014, nga të cilat konstatohet se objekt i shqyrtimit i procedurës së lartcekur kanë qenë 156 deklarata doganore, duke u bazuar në Raportin e Auditimit të datës 05.12.2013, dhe vendimin e Sektorit të Auditimit të të paditurit, dhe se në provat të cilat prokurori i shtetit i ka propozuar që të shqyrtohen në procedurë penale ka qenë pikërisht vendimi i Sektorit të Auditimit, gjegjësisht Raporti i Kontrollit i datës 05.12.2013 që ka të bëjë me deklaratat doganorë të cilat janë objekt i padisë.

Pra, gjykata vlerëson se në rastin konkret e paditura gabimisht ka vendosur kur ka obliguar subjektin në procedurë këtu paditësin që të paguajë detyrime shtesë me vendim administrativ, sepse nga provat e lartcekura vërtetohet se kjo çështje është gjykuar me vendim të formës së prerë në procedurë penale ku objekt trajtimi siç u theksua më lartë kanë qenë 156 deklarata unike doganore dhe gjetjet siç janë marrë në aktvendimin bazë nr. 791/03.12.2013. Prandaj, nga gjendja faktike e vërtetuar më lartë, Gjykata përfundimisht cilëson se pretendimet e paditësit janë plotësisht të bazuara dhe të drejta dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pa kontestueshëm nga pikëpamja ligjore, andaj vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe anuluar aktvendimin nr.07.3/200-2014 i datës 18.10.2021 të Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura që edhe njëherë të vlerësoj rrethanat sikurse më lartë dhe vetëm pas kësaj dhe mbi bazën e konstatimit të saktë të gjendjes faktike të sjell vendim të drejtë dhe të bazuar në Ligj.

Ligji Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 44 1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Prandaj, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, kjo edhe pasi që ka konstatuar se ka shkelje të ligjit në dëm të këtu paditësit andaj edhe doemos u desh që ky aktvendim të anulohet.

E paditura në rishqyrtim dhe rivendosje me rastin e ndërmarrjes së verifikimeve të reja për DUD-at kontestues, DUD-a këta që janë trajtuar edhe në procedurë penale me aktgjykim të formës së prerë, respektivisht me aktgjykimin P.nr.412/14 të datës 21.06.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 04.10.2016, nuk ka pasur parasysh kufizimet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 219, par 3. lidhur me nenin 82 të KDA-së, e ku decidivisht thuhet se *“Komunikimi i shumës së borxhit doganor nuk mund t’i bëhet debitorit pas kalimit të afatit prej*

tre viteve, nga data në të cilin lind borxhi doganor”, andaj e paditura përveç të gjeturave si më lartë për qëllime të konstatimit të saktë të gjendjes faktike në tërësinë e saj duhet të këtë parasysh dispozitat ligjore si më lartë ashtu që të deklarohet për veprimet e ndërmarra brenda afateve ligjore dhe nëse eventualisht ka veprime edhe jashtë këtyre afateve.

Të metat e lartcekura janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata në rivendosje e obligon të paditurën që të konstatoj saktë gjendjen faktike, të marr për bazë aktgjykim e formës së prerë në procedurë penale, respektivisht aktgjykimin P.nr.412/14 të datës 21.06.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 04.10.2016, të deklarohet se mbi bazën e cilave prova konkrete e ka ngarkuar paditësin me detyrime doganore për periudhën e kontrollit ndryshe nga ato të trajtuara me aktgjykimin penal sikurse më lartë, të deklarohet lidhur me kufizimet ligjore për komunikim të borxhit pas lirit të mallit në qarkullim të lirë siç është potencuar në nenin 219.3 lidhur me nenin 82 të KDA-së. Në ri procedurë e paditura të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, të verifikoj dhe të konstatoj saktë gjendjen faktike nga e cila rrjedh edhe zbatimi I bazës ligjore dhe vetëm pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata i pati parasysh edhe deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen në padi dhe atyre në seancë gjyqësore, mirëpo gjeti se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike administrative. Pala paditëse, konstatimet siç u theksuan edhe më lartë i ka bazuar në dokumente të besueshme të cilat janë administruar si prova në çështje penale të kapitalizuara me aktgjykim të formës së prerë, por edhe nga kjo gjykatë e të cilat nuk ka mundur ti kundërshtoj as e paditura me ndonjë provë materiale. Gjykata vendos për çështjen e kontestit tregtar administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u parashtrua më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 46 par. 1, 2, dhe 3 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë / Departamenti Fiskal
KF.nr.262/2022, datë 14.03.2024

Zyrtare Ligjore
Amire JAHIRI

Gj y q t a r i
Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.